REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-20608/26 datë: 21.09.2026

Npi – 01/269 datë: 29.09.2026

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera Nr.04/L-27; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 29.09.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DISKUTIM PUBLIK
TË DRAFT-VLERËSIMIT TË RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË KOMUNËN E SHTIMES PËR VITIN 2026.

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 29.09.2026, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Shtimes për vitin 2026, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të procesit të diskutimit publik janë: Drejtoria për Shërbime Publike - Zyra për Mbrojtje dhe Shpëtim, Komisioni për hartimin e Draft-Vlerësimit dhe Zyra për Informim.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE
V.v.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi